



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.25/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosovski Savez, me seli në Leposaviq, e paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 22.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Kosovski Savez, me seli në Mitrovicën e Veriut, ZP.Anr.25/2025, e datës 19.12.2025, kundër Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Leposaviq, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 20,000.00 (njëzetë mijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet subjekti politik Lista Serbe me seli në Mitrovicën e Veriut, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi t'i largoj te gjithë posterat dhe materialet zgjedhore nga vendet e hapësirave publike, të përshkruara më ankesën e datës 19.12.2025.

A r s y e t i m

Me datë 19.12.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik Kosovski Savez, ku pretendohet më datën 18.12.2025, aktivistët e subjektit politik Kosovski Savez vunë re se aktivistët e Srpska Lista në komunën e Leposaviqit kanë vendosur materialin e tyre propagandistik tek stacioni i autobusëve Slatina (përballë stacionit hekurudhor) –

drejtimi për në Mitrovicë, stacioni i autobusëve Slatina (përballë stacionit hekurudhor) drejtimi për në Soçanicë, stacioni i autobusëve Soçanicë, stacioni i autobusëve Ibarska Slatina drejtimi për në Mitrovicë, stacioni i autobusëve Ibarska Slatina – drejtimi për në Leposaviq, terreni sportiv, fshati Vuçë në komunën e Leposaviqit, ndriçimi rrugor, fshati Vuçë, ndriçimi rrugor, rruga Vëllazërit Radovanoviq – Soçanicë, ndriçimi rrugor – përballë Shkollës Fillore "Vuk Karadžić" Soçanicë, në komunën e Leposaviqit – ndriçimi rrugor – drejtimi rrugor Soçanicë – Jevticë, Krsmal, Borçan, fshati Borovë – shkolla bujqësore – Leshak, fshati Borovë – ndriçimi rrugor – Leshak, në komunën e Leposaviqit – stacioni i autobusëve Trepça-Flotacion, rruga Vojskë J., te Banka Ekonomike, ndërtesa e gjykatës në Leposaviq, Stacioni i Autobusëve në Leposaviq, rruga Dositel Obradoviq në Leposaviq, rruga Dositej Obradoviq te Shkolla e Lartë Ekonomike, në komunën e Leposaviqit – lagja Çukarak – shtyllë elektrike, në komunën e Leposaviqit – rruga 29. Nëntor te posta dhe Interex, mbikalimi në hyrje të Leshakut, në komunën e Leposaviqit – rruga Vëllazërit Matoviq – shtyllë elektrike – Leshak, rruga Vëllazërit Matoviq – shtyllë elektrike, rruga drejt fabrikës Ivo Lola Ribar – Leshak, rruga Vëllazërit Matoviq – nënstation elektrik – Leshak, rruga Vëllazërit Matoviq – parku pranë shkollës fillore Stana Baçanin – Leshak, – rruga Vëllazërit Matoviq – parku pranë nënstationit elektrik – Leshak, rruga Vëllazërit Matoviq – Shtëpia e Shëndetësisë – Leshak, rruga Vëllazërit Matoviq – lokal në zyrën e Agjencisë për Privatizim – Leshak, në komunën e Leposaviqit – stacioni i autobusëve Jarinjë, stacioni i autobusëve Jarinjë, drejtimi drejt Mitrovicës, në komunën e Leposaviqit – fshati Dobravë, fshati Dobravë, stacion autobusi – drejtimi nga Soçanica drejt Leposaviqit, fshati Dobravë, stacion autobusi – drejtimi nga Leposaviqi drejt Soçanicës, rruga Vojskë J., kioskë në pronësi të komunës së Leposaviqit

Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime është shkelur Rregullora Zgjedhore nr. 7/2024. Andaj propozon që PZAP të pranojë ankesën si të bazuara, që në përputhje me rregulloret të shqiptojë dënimet përkatëse ndaj subjektit politik Lista Serbe. I njëjti për të mbështetur pretendimet e tij me ankese si dëshmi i ka bashkangjitur fotografat në vendet ku janë të vendosura ato.

Subjekti politik Lista Serbe përkundër që është e njoftuar me ankesën, e njëjta nuk ka ofruar përgjigje në ankesë.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës vlerësoi se:

- Ankesa është e bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndëve përkatësisht ankesës ZP.Anr.26/2025 dhe materialit provues bashkangjitur ankesës, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Kosovski Savez, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesën e parashtruar, paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Lista Serbe, rrjedhimisht ky subjekt politik ka vendosur material promovues zgjedhor në hapësira publike (shtylla elektrike, parqe, stacion të autobusit, mbikalim, trafo-stacione elektrike, rruge publike). Andaj me këto veprime

ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Subjekti Politik Lista Serbe ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore, andaj vendosja e materialeve promovuese në fushatë zgjedhore pa lejen e organeve kompetente, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, të cilat shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të LZP-së.

Përkundër njoftimit nga PZAP-i me ankesën, subjekti politik Lista Serbe nuk ka ofruar ndonjë përgjigje në lidhje me pretendimet e palës ankuese.

Duhet pas parasysh se në këtë vendim janë përfshi një numër i konsiderueshëm i shkeljeve të dëshmuara, ndërsa lartësia e dënimit i përgjigjet natyrës së shkeljes dhe praktikës së ndjekur nga paneli për raste të tilla. Pra, paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, respektivisht faktin se i njëjti subjekt ka qene i njoftuar me rregullat zgjedhore, po ashtu është marr për baze edhe përsëritja e shkeljeve të njëjta nga ana e këtij subjekti.

Paneli vlerëson se në rastin konkret subjekti politik Lista Serbe duhet që menjëherë ti largoj posterat dhe materialet tjera zgjedhore nga vendet ku janë të vendosura ato, ashtu siç janë potencuar me ankesën ZP Anr 26/205 të datës, të datës 19.12.2025, ndërsa dështimi për ti hequr apo kundërshtimi për t’iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim tjetër shtesë nga PZAP, ashtu siç është përcaktuar me nenin 120, par.2 të LZP.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e palës ankuese janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi si të bazuara, sepse shkeljet kane të bëjnë me Kodin e Mirësjelljes, e qe i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod, me qëllim të krijimit të kushteve të favorshme që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Andaj, veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën siç është cek me lartë e pranoi si të bazuar.

Andaj si përfundim, paneli ka vlerësuar se veprimet e subjekti politik Lista Serbe janë në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe nenin 120 par 2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 2 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.Anr.25/2025 më datën 22.12.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.